

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**Nr. 2382 / prot.Tiranë, më 22 / 10 / 2024Lënda: 4 Kthim përgjigje**Z. DORIAN MATLIJA
QENDRA "RES PUBLICA"****Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë**

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-288, datë 08.01.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Drejtorisë së Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. D-288/2 prot., datë 16.01.2024 si më poshtë:

"Në vijim të shkresës sipërcituar, Drejtoria e Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit i është drejtuar me shkresë zyrtare me nr. prot. D-288/1, datë 12.01.2024 Drejtorive përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës për të vënë në dispozicion informacionin në lidhje me pyetjet që ju kenë adresuar ndaj institucionit të Bashkisë së Tiranës.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe perzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për secilen fazë të procesit të rindërtimit, referuar pikës nr. 3, aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza, përkatësisht:

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre së bashku me dokumentat e kërkuara për të përfituar nga programi i rindërtimit, si dhe në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar nga programet e rindërtimit.

Kjo procedurë është zhvilluar në tre faza, në muajt Shkurt 2020, Korrik 2020 dhe Dhjetor 2020, ku në total për Njësinë Administrative nr. 6, në Bashkinë e Tiranës janë trajtuar në total 2711 praktika aplikimi, 1137 aplikime (ku ndër to janë shpallur përfitues me nivel dëmi DS1-DS3, 978 praktika dhe 159 praktika jopërfituese). Gjithashtu, praktika

individuale të trajtuara me nivel dëmi DS4-DS5, total 128 praktika (100 praktika të shpallura përfituese me nivel dëmi DS4 dhe DS5 si dhe 28 praktika jopërfituese me po të njëjtin nivel dëmi). Ndërsa për sa i përket aplikimeve të godinave në bashkëpronësi (pallatet), janë trajtuar pranë Bashkisë së Tiranës 1446 praktika në total, (ku 670 praktika janë përfitues dhe 152 praktika jopërfitues).

Përsa i përket pikës në të cilën ju kërkon informacion për arsyet kryesore të skualifikimit të tyre, theksojmë se çdo vendimmarrje për subjektet që kanë aplikuar në procesin e rindërtimit është i referuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore, në Vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe Vendimi nr. 70/2020 i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e udhëzuesit, për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit" dhe Vendimi nr. 57/2020 i Këshillit Bashkiak "Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, dhe miratimin e udhëzuesit "Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit".

Referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 16.02.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", referuar Nenit nr. 5, pika nr. 3 përcakton se "Nuk është subjekt përfitues individi ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e veteqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individi ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm. Nëse pas përfitimit, sipas kësaj pike, banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor, përfitimi i sipërfaqeve në ndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti".


Gjithashtu, arsye të tjera për moskualifikimin e tyre janë mangësitë në dokumentacion, akt ekspertizat/akt konstatimet e lëshuara nga grupet përkatese të inspektimit ku vertetojnë se dëmet nuk kanë ardhur prej termetit të nëntorit 2019, por prej amortizimit që kanë pësuar banesat në kohë".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha





Res Publica <qendra.respublica@gmail.com>

01/2
2382

Përgjigje nga Bashkia Tiranë

E Drejta Per Informim <edrejtaperinformim@tirana.al>

Fri, Jan 19, 2024 at 12:26 PM

To: "qendra.respublica@gmail.com" <qendra.respublica@gmail.com>

Përshëndetje,

Në vijim të kërkesës suaj ardhur pranë Bashkisë Tiranë dhe protokolluar me nr. prot. D-288, datë 08.01.2024, për të cilën ka përgjigje nga strukturat si vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar Drejtoria e Strehimit Social ju bën me dije se:

Familjet/Individët banesa e të cilëve është prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019, janë trajtuar me pagesën e qirasë sipas Vendimit Nr 129 datë 03.12.2019 "Për pagesën e plotë të qirasë sipas vlerës së tregut për familjet që janë dëmtuar nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019" dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 1 datë 14.01.2021 "Për zgjatjen e afatit të pagesës së qirasë sipas vlerës së tregut të lirë, për familjet/ individët, banesat e të cilëve si rezultat i tërmetit të datës 26 nëntor 2019 janë shembur ose janë deklaruar të pabanueshme nga akt konstatimet e hartuara nga instituti i ndërtimit" janë trajtuar me pagesën e qirasë. Në vijim Këshilli Bashkiak ka miratuar 13 (trembëdhjetë) vendime për trajtimin me pagesë qiraje të familjeve të prekura nga tërmeti, ku (1433) njëmijë e katërqind e tridhjetë (1) tre) i përkasin Njesisë Administrative Nr. 6. Aktualisht, referuar listëpagesës së muajt dhjetor 2023 rezultojnë 1050 (2) njëmijë e pesëdhjetë) përfitues".

Drejtorja e Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit informon se:

"Në vijim të shkresës sipërcituar, Drejtoria e Koordinimit Monitorimit Bashkërendimit të Rindërtimit i është drejtuar drejtorive përkatëse sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës për të vënë në dispozicion informacionin në lidhje me pyetjet që ju keni adresuar ndaj institucionit të Bashkisë së Tiranës.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe perzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar, vendimit nr. 5, datë 06.01.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë, për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për secilën fazë të procesit të rindërtimit, referuar pikës nr. 3, aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza, përkatësisht:

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre së bashku me dokumentat e kërkuara për të përfituar nga programi i rindërtimit, si dhe në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/o individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar nga programet e rindërtimit.

Kjo procedurë është zhvilluar në tre faza, në muajt Shkurt 2020, Korrik 2020 dhe Dhjetor 2020, ku në total për Njesisë Administrative nr. 6, në Bashkinë e Tiranës janë trajtuar në total 2711 praktika aplikimi, 1137 aplikime (ku ndër to janë shpallur përfitues me nivel dëmi DS1-DS3, 978 praktika dhe 159 praktika jopërfituese). Gjithashtu, praktika individuale të trajtuara me nivel dëmi DS4-DS5, total 128 praktika (100 praktika të shpallura përfituese me nivel dëmi DS4 dhe DS5 si dhe 28 praktika jopërfituese me po të njëjtin nivel dëmi). Ndërsa për sa i përket aplikimeve të godinave në bashkëpronësi (pallatet), janë trajtuar pranë Bashkisë së Tiranës 1446 praktika në total, (ku 670 praktika janë përfitues dhe 152 praktika jopërfitues).

Përsa i përket pikës në të cilën ju kërkon informacion për arsyet kryesore të skualifikimit të tyre, theksojmë se çdo vendimmarrje për subjektet që kanë aplikuar në procesin e rindërtimit është i referuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore, në Vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe Vendimi nr. 70/2020 i Këshillit Bashkiak "Për miratimin e udhëzuesit, për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit" dhe Vendimi nr. 57/2020 i Këshillit Bashkiak "Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, dhe miratimin e udhëzuesit "Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit".

Referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 16.02.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", referuar Nenit nr. 5, pika nr. 3 përcakton se "Nuk është subjekt përfitues individ ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e veteqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore,

pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individit ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm. Nëse pas përfitimit, sipas kësaj pike, banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor, përfitimi i sipërfaqeve në ndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti".

Gjithashtu, arsye të tjera për moskualifikimin e tyre janë mangësitë në dokumentacion, akt ekspertizat/akt konstatimet e lëshuara nga grupet përkatëse të inspektimit ku vërtetojnë se dëmet nuk kanë ardhur prej tërmetit të nëntorit 2019, por prej amortizimit që kanë pësuar banesat në kohë".

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Ju urojmë ditë të mbarë.

KOORDINATORE PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



Bashkia Tiranë

Sheshi "SKËNDERBEJ",
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

Web: www.tirana.al

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privileguara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse , përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6

Nr. prot 172/4

Tiranë, më 12 . 02 . 2024

Lënda: Dërgim Informacioni.

QENDRA “RES PUBLICA”
Përfaqësuar nga z.Dorian Matlija
Adresa: Blv “Gjergj Fishta”, Nd.24, H.3, Ap.7, Tiranë

Në vijim të korespodencave me Drejtorinë e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, Drejtoria Juridike, Bashkia Tiranë po ju dërgojmë informacionin që Njësia Administrative Nr.6 disponon, si mëposhtë:

Konform Vendim nr. 70, datë 12.06. 2020 “Për Miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit” Njësia Administrative ka realizuar procedurën e aplikimit dhe përcjelljen e dokumentacionit pranë Bashkisë Tiranë, trajtimi dhe shqyrtimi nuk është kompetencë e Njesisë Administrative. Në Njësinë Administrative nr.6 kanë aplikuar 2861 individë/familje në total gjatë tre periudhat që është hapur platforma online “Shtëpia Ime”, prej të cilave 1713 janë më statusin DS4-DS5. Në lidhje me trajtimin ose mos trajtimin me bonus qiraje, nga programet e rindërtimit, demolimi i pallateve, proceset gjyqësore, nuk janë kompetencë e Njesisë Administrative.

Bashkëlidhur gjeni korespodencën me Drejtorinë Juridike.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

ADMINISTRATOR

Matilda Cullhaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE E ASETVE DHE LICENCIMIT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 111-1485/prot.

Tiranë, më 05, 02, 2024

Lënda: Kthim përgjigje.

NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 6

TIRANË

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. NJ-1485 prot., datë 26.01.2024, nëpërmjet të cilës na informoni mbi numrin total të individëve/familjeve që kanë aplikuar në platformën online "Shtëpia Ime", për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit, duke specifikuar sa raste janë shpallur në total nga këto aplikime me statusin DS4-DS5, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Drejtoria Juridike, me anë të shkresës nr. D-288/3 prot., datë 17.01.2024, ju ka bërë me dije se informacionin e përcjellë me shkresën e lartpërmendur, duhet t'ia drejtoni drejtpërsëdrejti subjektit të interesuar, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", të ndryshuar.

Për sa më sipër, bashkëlidhur kësaj shkrese po ju ridërgojmë përgjigjen e dërguar nga ana juaj, me qëllim vijimin e korrespondencës me av. Dorian Matlija, përfaqësues i qendrës "Res Publica".

DREJTORI PËRGJITHSHËM
Alban Dokushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 6

Nr. prot 172/

Tiranë, më 24. 01 . 2023

Lënda: Kthim përgjigje.

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE, ASETVE DHE LICENCIMIT
DREJTORIA JURIDIKE

I nderuar **z. Alban Dokushi**, Drejtor i Përgjithshëm

Në përgjigje të shkresës tuaja nr.D-288/3 prot. datë 17.01.2024, protokolluar nr. 172 datë 19.01.2024 “Për Kompetencë” me anë të së cilës na përcillni kërkesën e av. Dorian Matlija, përfaqësues i qendrës “Res Publica” që kërkon informacion në lidhje me tërmetin e 26 nëntorit të 2019, ju shpjegojmë si mëposhtë:

Konform Vendim nr. 70, datë 12.06. 2020 “Për Miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfutur nga programet e procesit të rindërtimit” Njësia Administrative ka realizuar procedurën e aplikimit dhe përcjelljen e dokumentacionit pranë Bashkisë Tiranë, trajtimi dhe shqyrtimi nuk është kompetencë e Njesisë Administrative. Në Njësine Administrative nr.6 kanë aplikuar 2861 individë/familje në total gjatë tre periudhat që është hapur platforma online “Shtëpia Ime”, prej të cilave 1713 janë më statusin DS4-DS5. Në lidhje me trajtimin ose mos trajtimin me bonus qiraje, nga programet e rindërtimit, demolimi i pallateve, proceset gjyqësore, nuk janë kompetencë e Njesisë Administrative.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

ADMINISTRATOR

Matilda Cullhaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. D-288 / prot.Tiranë, më 26 / 01 / 2024Lënda: 7 Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA ✓

QENDRA "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7,

Njësia Administrative nr. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-288, datë 08.01.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim edhe pranë struktura të tjera të Bashkisë Tiranë, të cilat kanë kthyer përgjigje si vijon:

"Drejtorja e Emergjencave Civile pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile me shkresën me nr. prot. D-288/5, datë 24.01.2024 informon se bazuar në ligjin nr. 119, datë 18.09.2014 dhe dispozitave të tjera në fuqi, ju është përgjigjur kërkesave tuaja rast pas rasti duke ju informuar dhe vënë dispozicion informacionin që disponon.

Sa më sipër, edhe bazuar në Vendimin nr. 46111, datë 29.12.2022, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë për "Miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave të institucionit të Bashkisë Tiranë", kemi të dhënat si më poshtë:

Në zonën e Kombinatit, Njësia Administrative nr. 6 deri tani janë shembur/demoluar 29 objekte të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019. Nga vlerësimi teknik i kryer nga ekspertë të fushës do të demolohen edhe 12 objekte në vijim".

Ndërkohë Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT) me shkresën me nr. 570/1 prot., datë 22.01.2024 informon se IMT pranë Bashkisë Tiranë ushtron detyrat dhe kompetencat ligjore, në zbatim të Ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme" (i ndryshuar); Ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"; V.K.M.-së Nr.408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" (i ndryshuar); VKM-së Nr.894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit".


Gjithashtu, ju informojmë se për sa i përket kërkesës në lidhje me pallatet që janë shembur dhe sa prej tyre janë në plan për tu shëmbur, ju sqarojmë se demolimi dhe evadimi i mbetjeve ndërtimore janë kryer nga palë të treta të kontraktuara nga Bashkia Tiranë, dhe IMT nuk disponon informacion”.

Sa më sipër lutemi dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMITNr. D-288 / prot.Tiranë, më 16 / 02 / 2024Lënda: 11 Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA ✓

RES PUBLICA

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-288, datë 08.01.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim edhe pranë Drejtorisë së Koordinimit dhe Bashkërendimit të Rindërtimit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. D-288/9 prot. datë 13.02.2024 si edhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar me shkresën me nr. prot. D-288/10, datë 13.02.2024 si vijon:

"Në përgjigje të shkresës tuaj së sipërcituar, ku keni kërkuar informacion në lidhje me procesin e rindërtimit në Njësinë Administrative nr. 6, përkatësisht për zonën e Kombinatit.

Drejtorja e Koordinimit Bashkërendimit të Rindërtimit i është drejtuar me shkresë zyrtare D-288/1, datë 12.01.2024 drejtorive përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë dhe kompetencës për të vënë në dispozicion informacionin në lidhje me pyetjet e adresuara ndaj institucionit të Bashkisë së Tiranës.

Në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga parashikimet e vendimit nr. 904, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit", të ndryshuar vendimit nr. 5, datë 6.1.2020, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model", të ndryshuar, Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë, për përcaktimin e strukturave përgjegjëse për secilën fazë të procesit të rindërtimit, referuar pikës nr. 3, aplikimi për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij vendimi bëhet me dy faza, përkatësisht:

Në fazën e parë aplikantët paraqesin kërkesën e tyre sëbashku me dokumentat e kërkuara për të përfituar nga programi i rindërtimit, si dhe në fazën e dytë të aplikimit përfshihen vetëm ata/ato individë/familje që janë përzgjedhur për t'u trajtuar nga programet e rindërtimit. Kjo procedurë është zhvilluar në tre faza, në muajt Shkurt 2020, Korrik 2020 dhe Dhjetor 2020, ku në total për Njësinë Administrative nr. 6, në Bashkinë e Tiranës janë trajtuar në total 2088 praktika aplikimi, 1137 aplikime (ku ndër to janë shpallur përfitues me nivel dëmi DS1-DS3 978 praktika dhe 159

praktika jopërfituese). Gjithashtu, praktika individuale të trajtuara me nivel dëmi DS4 total 34 praktika (27 praktika të shpallura përfituese si dhe 7 praktika jopërfituese me po të njëjtin nivel dëmi). Total praktika me nivel dëmi DS5 janë trajtuar 94 (ku 73 janë përfitues si dhe 21 praktika jopërfituese). Ndërsa për sa i përket aplikimeve të godinave në bashkëpronësi (pallatet), janë trajtuar pranë Bashkisë së Tiranës 822 praktika në total, (ku 670 praktika janë përfitues dhe 152 praktika jopërfitues).

Përsa i përket pikës, në të cilën kërkohet informacion mbi arsyet kryesore të moskualifikimit, theksojmë se çdo vendimmarrje për subjektet që kanë aplikuar në procesin e rindërtimit është referuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore, në Vendimet e Këshillit të Ministrave si dhe Vendimi nr. 70/2020 i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga programet e procesit të rindërtimit” dhe Vendimi nr. 57/2020 i Këshillit Bashkiak “Për përcaktimin e masës së vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, dhe miratimin e udhëzuesit “Për detajimin e procedurave për të përfituar nga nënprogrami i grantit të rikonstruksionit”.

Referuar Aktit Normativ nr. 9, datë 16. 02.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, referuar Nenit nr. 5, pika nr. 3 përcakton se “Nuk është subjekt përfitues individ ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individ ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm. Nëse pas përfitimit, sipas kësaj pike, banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor, përfitimi i sipërfaqeve në ndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti”.

Gjithashtu, arsye të tjera për moskualifikimin e tyre janë mangësitë e dokumentacioneve në praktikën e aplikimit, akt ekspertizat/akt konstatimet e lëshuara nga grupet përkatëse të inspektimit ku vërtetojnë se dëmet nuk kanë ardhur prej tërmetit të nëntorit 2019, por prej amortizimit që kanë pësuar banesat në kohë”.

Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar në lidhje me numrin e familjeve që vijnë ende të përfitojnë bonusin e qerasë në zonën e Kombinatit (Njësia Administrative nr. 6) informon se numri i përfituesve të Bonusit të Tërmetit për muajin Dhjetor 2023, referuar shkresës së Drejtorisë së Strehimit Social me nr. prot. 44128, datë 19.12.2023 është 1050 (një mijë e pesëdhjetë) përfitues me vlerë totale 20,640,000 (njëzetë milion e gjashtëqind e dyzet mijë) lekë.

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMITNr. D-288 / prot.Tiranë, më 21 / 03 / 2024Lënda: 13 Kthim përgjigje

Z. DORIAN MATLIJA ✓

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. D-288, datë 17.01.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim edhe pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. prot. D-288/12, datë 13.03.2024 si vijon:

"Në përgjigje të shkresës tuaj, ku keni kërkuar informacion në lidhje me procesin e rindërtimit të zonës së re për zhvillim "Kombinati" Drejtoria Lejeve për Zhvillimin e Territorit, ju bën me dije se, Në analizë të përmbajtjes së kësaj shkrese si dhe në mbështetje të Ligjit 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", (i ndryshuar); VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar), si dhe parashikimeve ligjore të Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; (e ndryshuar), Drejtoria e Lejeve për Zhvillimin të Territorit brenda fushës, përgjegjësisë dhe kompetencave të kësaj drejtorie ju informon se nga verifikimi i sistemit elektronik e-leje rezulton se;

1. Me Vendimin Nr. I-19417/2, datë 11.11.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 4 kate, nr. 147", në rrugën "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
2. Me Vendimin Nr. I-19485/2, datë 11.11.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 150", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
3. Me Vendimin Nr. I-20973/2, datë 11.11.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 140", ndodhur në rrugën "Sokrat Mosko" Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
4. Me Vendimin Nr. I-21010/2, datë 24.03.2023, u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kat, nr. 73/2", në rrugën "Niko Avrami", Njësia Administrative nr. 4, Tiranë.
5. Me Vendimin Nr. M-21669/2, datë 11.11.2020 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallat ekzistues 5 kat, nr. 141, (banesë kolektive)", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.

6. Me Vendimin Nr. M-22017/2 datë 11.11.2020 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kat, nr. 152/3, (banesë kolektive)", në rrugën "Haki Stërmilli", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
7. Me Vendimin Nr. I-20977/2, datë 23.01.2023 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 2 kat, nr. 66", në rrugën "Aleksandër Moisiu ", Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë.
8. Me Vendimin Nr. I-21739/2, datë 30.11.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 164/2", në rrugën "Ali Kelmendi ", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
9. Me Vendimin Nr. I-21855/2, datë 30.11.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 168", në rrugën "Hamdi Cenoimeri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.
10. Me Vendimin Nr. M-22016/2, datë 23.12.2020 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallatin ekzistues 5 kat, nr. 145, (banesë kolektive)", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
11. Me Vendimin Nr. M-22054/2, datë 23.10.2020 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallat ekzistues 5 kat, nr. 154, (banesë kolektive)", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
12. Me Vendimin Nr. M-23281/2, datë 05.01.2022 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallatin ekzistues 5 kat, nr. 158", në rrugën "Llambi Bonata", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
13. Me Vendimin Nr. M-23279/2, datë 07.12.2021 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kat, nr. 14", ndodhur në rrugën "Llambi Bonata", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
14. Me Vendimin Nr. M-23282/2, datë 07.12.2021 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 3 kat, nr. 138", ndodhur në rrugën "Haki Stërmilli", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
15. Me Vendimin Nr. M-23286/2, datë 07.12.2021 u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kat, nr. 161", ndodhur në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.
16. Me Vendimin Nr. M-22056/2, datë 23.11.2020, u miratua leja e ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallat ekzistues 5 kat, nr. 159, (banesë kolektive)", në rrugën "Llazi Miho", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë.

Bashkëlidhur kësaj kthim përgjigje gjeni vendimet e sipërcituara të gjeneruar, nga sistemi elektronik e-leje".

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Blerta Goxha



V E N D I M

Nr. I-19417/2

P Ë R

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 4 kate, nr. 147", në rrugën "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e K.K.T-së Nr. 1, datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor", Bashkia Tiranë; Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara"; Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ ndërtimit, deklaratë paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 13.10.2022 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN240820220106 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. I-19417, datë 24.08.2022, për leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 4 kate, nr. 147", në rrugën "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.

V E N D O S A:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 4 kate, nr. 147", në rrugën "Tanush Frashëri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë;
2. Afati i lejes së ndërtimit është 9 muaj, nga miratimi i këtij vendimi;
3. Bazuar në Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe në nenin 34 të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", kjo leje përjashtohet nga taksa për ndikimin në infrastrukturë si dhe tarifa e aplikimit;
4. Zhvilluesi të marrë të gjitha masat që shembja e strukturave të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, në mënyrë që të mos ketë dëme të shkaktuara, qoftë edhe të përkohshme të objekteve pranë strukturave që do shëmben. Për çdo dëmtim apo shkarje të rrugëve dhe/ose të objekteve fqinjë, zhvilluesi do të mbajë përgjegjësi ligjore;
5. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
6. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

 Erion Veliaj
2022.11.11
11:41:31 +01'00'

ERION VELIAJ

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT:
Drejtor DKZHT (i deleguar):
Përgjegjës SR:
Përgjegjës ST:
Specialiste/Juriste /SSHA:
Specialist SR:

Frida Pashako
Driton Shkurtaj
Alba Metoja
Enkelejda Murta
Romina Yzellari
Matilda Sotiri

Frida Pashako
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

Driton Shkurtaj
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

Alba Metoja
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

Enkelejda Murta
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

Romina Yzellari
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

Matilda Sotiri
2022.11.11 11:41:31 +01'00'
1431512-102107

V E N D I M

Nr. I-19485/2

PËR

**Miratimin e lejes së ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore",
për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 150", në rrugën "Sokrat Mosko",
Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.**

Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e K.K.T-së Nr. 1, datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor", Bashkia Tiranë; Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara"; Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, certifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 13.10.2022 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN250820220029 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. I-19485, datë 25.08.2022, për leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 150", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.

V E N D O S A:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 150", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë;

2. Afati i lejes së ndërtimit është 9 muaj, nga miratimi i këtij vendimi;
3. Bazuar në Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe në nenin 34 të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", kjo leje përjashtohet nga taksa për ndikimin në infrastrukturë si dhe tarifa e aplikimit;
4. Zhvilluesi të marrë të gjitha masat që shembja e strukturave të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, në mënyrë që të mos ketë dëme të shkaktuara, qoftë edhe të përkohshme të objekteve pranë strukturave që do shëmben. Për çdo dëmtim apo shkarje të rrugëve dhe/ose të objekteve fqinjë, zhvilluesi do të mbajë përgjegjësi ligjore;
5. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
6. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

Erion Veliaj

2022.11.11

11:43:10 +01'00'

ERION VELIAJ

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT:
Drejtor DKZHT (i deleguar):
Përgjegjës SR:
Përgjegjës ST:
Specialiste/Juriste /SSHA:
Specialist SR:

Frida Pashako Frida Pashako
Ditton Shkurtaj Ditton Shkurtaj
Alba Metoja Alba Metoja
Enkelejda Murta Enkelejda Murta
Romina Yzellari Romina Yzellari
Matilda Sotiri Matilda Sotiri

VENDIM

Nr. I-20973/2

PËR

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore" për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 140", ndodhur në rrugën "Sokrat Mosko" Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.


Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e K.K.T-së Nr. 1, datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor", Bashkia Tiranë; Ligjin nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara"; Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, certifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhrin nr.11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 13.10.2022 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN140920220026 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. I-20973, datë 14.09.2022, për leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 140", në rrugën "Sokrat Mosko" Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.

VENDOSA:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore" për objektin "Pallati ekzistues 5 kate, nr. 140", në rrugën "Sokrat Mosko", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë;

2. Afati i lejes së ndërtimit është 9 muaj, nga miratimi i këtij vendimi;
3. Bazuar në Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe në nenin 34 të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", kjo leje përjashtohet nga taksa për ndikimin në infrastrukturë si dhe tarifa e aplikimit;
4. Zhvilluesi të marrë të gjitha masat që shembja e strukturave të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, në mënyrë që të mos ketë dëme të shkaktuara, qoftë edhe të përkohshme të objekteve pranë strukturave që do shëmben. Për çdo dëmtim apo shkarje të rrugëve dhe/ose të objekteve fqinjë, zhvilluesi do të mbajë përgjegjësi ligjore;
5. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
6. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR



Erion Veliaj
2022.11.11 11:47:11
+01'00'

ERION VELIAJ

Drejtore i Përgjithshëm DPPZHT:
Drejtore DKZHT (i deleguar):
Përgjegjës SR:
Përgjegjës ST:
Specialiste/Juriste /SSHA:
Specialist SR:

Frida Pashako
Ditton Shkurtaj
Alba Metoja
Enkelejda Murta
Romina Yzellari
Matilda Sotiri
Zazani

Frida Pashako
Ditton Shkurtaj
Alba Metoja
Enkelejda Murta
Romina Yzellari
Matilda Sotiri
Zazani

Digitaly signed by
Romina Yzellari
Date: 2022.11.24
14:18:49 +0200

VENDIM

Nr. I-21855/2

PËR

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 168", në rrugën "Hamdi Cenoimeri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.


Mbështetur në nenin 8, pika 2; nenin 9, pika 1/1, shkronja "b"; nenin 23, pika 14; nenin 64 shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar); nenin 24 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për "Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit" (i ndryshuar); Vendimin e K.K.T-së Nr. 1, datë 14.04.2017 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor", Bashkia Tiranë; Ligjin nr. 45/2019, "Për mbrojtjen civile"; Aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore"; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 887, datë 24.12.2019 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore"; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara"; Urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë nr. 8741, datë 21.03.2016 "Për procedurën e shqyrtimit të aplikimeve të lejes së zhvillimit/ ndërtimit, deklarata paraprake për kryerje punimesh, çertifikatë përdorimi, gen-plane azhurnimi dhe përditësimet e infrastrukturave të tjera" (e ndryshuar); Urdhrin nr. 11987, datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë "Për ngritjen e Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë" (i ndryshuar); Manualin e Procedurave dhe Organizimit të Këshillit Teknik të Bashkisë Tiranë, miratuar me vendim nr. 11987/1 datë 20.04.2016 të Kryetarit të Bashkisë Tiranë (i ndryshuar); si dhe mbështetur në opinionin e datës 26.10.2022 të Këshillit Teknik, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së dorëzuar elektronikisht me numër aplikimi AN230920220025 dhe protokolluar në Bashkinë e Tiranës me nr. prot. I-21855, datë 23.09.2022, për leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 168", në rrugën "Hamdi Cenoimeri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë.

VENDOSA:

1. Të miratoj leje ndërtimi për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore", për "Pallatin ekzistues 5 kate, nr. 168", në rrugën "Hamdi Cenoimeri", Njësia Administrative Nr. 6, Tiranë;

2. Afati i lejes së ndërtimit është 9 muaj, nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit;
3. Bazuar në Ligjin nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin e territorit" (i ndryshuar) dhe në nenin 34 të Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", kjo leje përjashtohet nga taksa për ndikimin në infrastrukturë si dhe tarifa e aplikimit;
4. Zhvilluesi të marrë të gjitha masat që shembja e strukturave të bëhet në mënyrë të kontrolluar, duke respektuar rregullat e sigurimit teknik, në mënyrë që të mos ketë dëme të shkaktuara, qoftë edhe të përkohshme të objekteve pranë strukturave që do shëmben. Për çdo dëmtim apo shkarje të rrugëve dhe/ose të objekteve fqinjë, zhvilluesi do të mbajë përgjegjësi ligjore;
5. Për çdo ndërhyrje në rrjetin e infrastrukturës publike sipas projektit, të kontaktohet me institucionet përkatëse, në mënyrë që të mos krijohen probleme në rrjetin publik;
6. Pas përfundimit të punimeve të kthehet territori rrethues në gjendjen e mëparshme, të riparohen të gjitha dëmtimet në rrugë, trotuare, etj;
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETAR

 Erion Veliaj
2022.11.30
17:37:11 +01'00'

ERION VELIAJ

Drejtor i Përgjithshëm DPPZHT:
Drejtor DKZHT (i deleguar):
Përgjegjës SR:
Përgjegjës ST:
Specialiste/Juriste /SSHA:
Specialist SR:

Frida Pashako
Ditton Shkurtaç
Alba Metoja
Enkelejda Murtaç
Romina Yzellari
Matilda Sotiri


Digitally signed by Frida Pashako
DN: cn=Frida Pashako, o=DPPZHT, email=frida.pashako@dppzht.gov.al, c=AL


Digitally signed by Romina Yzellari
DN: cn=Romina Yzellari, o=DPPZHT, email=romina.yzellari@dppzht.gov.al, c=AL


Digitally signed by Matilda Sotiri
DN: cn=Matilda Sotiri, o=DPPZHT, email=matilda.sotiri@dppzht.gov.al, c=AL

VENDIM

Nr. I-20977/2

PËR

Miratimin e lejes së ndërtimit për "Prishjen e ndërtimeve të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore" për objektin "Pallati ekzistues 2 kat, nr. 66", në rrugën "Aleksandër Moisiu", Njësia Administrative Nr. 4, Tiranë.

